



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-24-0425**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**K.R.U. Ujësjiellësi Rajonal e Ujësjiellësit "Hidromorava" SH.A Gjilan,**

***kundër***

***E paditura/Ankuesja***

**NSH I.M.B "Kualiteti" (në likuidim), Gjilan, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0521 të datës 16 maj 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0521 i datës 16 maj 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 29 janar 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI005-0363 të datës 24 dhjetor 2013, me të cilën kërkesa e tij për kompensim të faturave të pa paguara të ujit për periudhën 01 shtator 2005 deri me 01 korrik 2008 në shumë prej 11,064.62 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se paditësi lidhur me kërkesën për të ofruar informacione dhe dokumente shtesë, nuk është përgjigjur në afatin e caktuar prej 15 ditësh të përcaktuar nga Autoriteti i Likuidimit, por paditësi me datë 12 qershor 2013 ka kthyer përgjigjen jashtë afatit të parashikuar në letrën e dërguar, për më tepër paditësi nuk dorëzoi kopjet e faturave për periudhën e kërkesës së tij, të cilat kërkoheshin si provë. Andaj në përputhje me nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit AKP-së, kërkesa e pa plotësuar me prova është refuzuar si e papranueshme.

Në ankesë paditësi pohoj se duke vepruar sipas kërkesës së Autoritetit të Likuidimit, edhe pse pas kalimit të afatit prej 15 ditësh, me 12 qershor 2013 ka parashtruar dokumentacionin-provat mbi të cilën mbështetej kërkesa, i cili dokumentacion përfshin ekstraktin nga Libri i kontabilitetit. Ky ekstrakt, sipas ankuesit, të gjitha të dhënat si ajo mbi emrin dhe shifrën e konsumatorit, adresën, datën e faturimit, vendi i faturimit, shuma e paguar dhe saldoja dhe është në përputhje të plotë me çdo faturë të lëshuar. Nga arsyet e cekura propozon që Vendimi i Autoritetit të Likuidimit të rishikohet dhe kërkesa e ankuesit të aprovohet.

Paditësi me ankesë ka bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit,
- Kopja e Ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për periudhën 1 shtator 2005 gjer 1 korrik 2008, nga e cila shihet borxhi i NSH ndaj ankuesit në shumë prej 11,064.62 ( në tekstin në vijim EKSTRAKTI), dhe
- Kopjet e faturave.

Me datë 01 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe paraqet mbrojtjen në ankesë të paditësit. AKP-ja në këtë parashtresë e kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP-së Autoriteti I Likuidimit me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP-ja tutje pohon se ankuesi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP-ja përfundimisht pohon se

ankuesi kërkesës mbi dokumentacion shtesë mbi kërkesën i është përgjigjur jashtë afatit prej 15 ditësh, andaj edhe është refuzuar si e pa bazuar. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankuesit të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit të vërtetohet si i bazuar në ligj.

Me 15 mars 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen e AKP-së. Paditësi i kundërshtoj pohimet e AKP-së si dhe mbeti në tërësi si pranë pretendimeve ankimore. Ankuesi edhe me anë të përgjigjes pohoj, se edhe pas kalimit të afatit 15 ditor, me 12 qershor 2013 ka parashtruar dokumentacionin-provat mbi të cilën mbështetej kërkesa, i cili dokumentacion përfshin ekstraktin nga libri i kontabilitetit e në cilën përfshihen të gjitha të dhënat si ajo mbi emrin dhe shifrën e konsumatorit, adresën, datën e faturimit, vendi i faturimit, shuma e paguar dhe saldoja dhe është në përputhje të plotë me çdo faturë të lëshuar.

Me datë 16 maj 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e shfuqizon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e obligon AKP-në, Autoritetin e Likuidimit që paditësit në emër të kompensimit të faturave të papaguara të ujit ti paguan shumën prej 11,064.62 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurë të likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi me anë të kërkesës së tij për rishikim-ankesës, ka parashtruar një kërkesë kreditore mbi kompensimin e borxhit mbi ujin e shpenzuar të NSH-së dhe asetëve të saj, në shumë totale prej 11,064.62 Euro. AKP-ja, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohej e drejta në kompensimin e faturave të ujit të shpenzuar. AKP-ja faktet, në këtë rast EKSTRAKTIN dhe FATURAT e prezantuara nga ankuesi, nuk i ka kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga faktet se, si në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit po ashtu edhe përgjigjen ndaj kërkesës për rishikim, AKP-a nuk e mohoj faktin se EKSTRAKTI është prezantuar pranë Autoritetit të Likuidimit por vetëm konstaton se kjo dëshmi është parashtruar jashtë afatit të paraparë prej 15 ditësh, të cilin fakt nuk e mohon as ankuesi. Në rastin konkret gjykata konsideron edhe nuk është kontestuese si në

vijim: borxhi, mbi kompensimin e faturave të ujit, nuk është kontestuar nga Autoriteti i Likuidimit, ankuesi megjithatë edhe pse jashtë afatit prej 15 ditësh, me 12 qershor 2013, pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar dhe ka dëshmuar ekzistimin e borxhit të NSH-së ndaj saj, dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit mbi kërkesën e ankuesit është lëshuar me 24 dhjetor 2013, çka do të thotë se Autoriteti i Likuidimit ka pasur njohuri mbi borxhin ekzistues për të cilën pretendon ankuesi, dhe atë që nga data 12 qershor 2013.(gjashtë muaj nga prezantimi i dokumentacionit të kërkuar nga data e lëshimit të Vendimit). Afatet referuese, sipas mendimit të gjykatës nuk paraqet afat prekluziv, si dhe në rastin konkret si dhe interpretimit të nenit 36.2.2, dispozitë kjo referuese, interpretimi i Autoritetit të Likuidimit së dispozitës ligjore, është i gabuar dhe atë nga arsyet si në vijim: neni 36 paragrafi 2.2, i Shtojcës së Ligjit për AKP, nuk parasheh afatin 15 ditor por aty thuhet vetëm nëse dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese, si dhe në rastin konkret edhe përkundër afatit, të parashtruar nga Autoriteti i Likuidimit, megjithatë ankuesi ka parashtruar dokumentacionin, dhe siç u cek si më lartë, Autoriteti i Likuidimit ka pasur njohuri mbi dokumentacionin e parashtruar që nga data 12 qershor 2013, e gjer me datën e lëshimit të vendimit me datë 24 dhjetor 2013. Për më tepër Autoritetit të Likuidimit, i është dhënë mundësia që të deklarohet edhe në procedurën e zhvilluar pranë gjykatës, por megjithatë Autoriteti i Likuidimit asnjëherë nuk i ka kontestuar provat e parashtruara nga ankuesi, por gjithnjë i referohet nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP si arsye e vetme mbi refuzimin. Gjykata, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, faturat e prezantuara, e që nuk janë kontestuar nga Autoriteti i Likuidimit, sipas nenit 493.2 paragrafi "d" të Ligjit (ligji nr. 03/L-006) për Procedurën Kontestimore, në rastin konkret i konsideron dokumente të besueshme dhe nuk mundet që mos ta pranoj si të pa-provuar kërkesën mbi borxhin ekzistues.

**Obiter dictum (ndër të tjerash)**

Edhe pse kjo nuk është pjesë e këtij aktgjykimi, gjykata gjatë shqyrtimit të lëndës, mbi pagesën e faturave të ujit, gjeti se kërkesa mund të jetë edhe e parashkruar, por pasi që pala kundërshtare asnjëherë, si me rastin e marrjes së Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, ashtu edhe në përgjigjen e saj, pranë DHPGJS, nuk thirret

apo nuk i referohet parashkrimit të kërkesës atëherë në pajtim me nenin 341 paragrafi 3 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve ( Ligji nr. 04/L-077), gjykata në rastin konkret nuk mund të aplikoj dispozitat mbi parashkrimin.

Me datë 27 maj 2024, e paditura përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-0521 të datës 16 maj 2024, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë e paditua ka pohuar se paditësi lidhur me kërkesën për të ofruar informacione dhe dokumente shtesë, nuk është përgjigjur në afatin e caktuar prej 15 ditësh të përcaktuar nga Autoriteti i Likuidimit, por paditësi me datë 12 qershor 2013 ka kthyer përgjigjen jashtë afatit të parashikuar në letrën e dërguar, për më tepër paditësi nuk dorëzoi kopjet e faturave për periudhën e kërkesës së tij, të cilat kërkoheshin si provë. Andaj në përputhje me nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit AKP-së, kërkesa e pa plotësuar me prova është refuzuar si e papranueshme. Tutje AKP-ja në ankesë ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Shkalla e I-rë ka juridiksion vetëm të verifikoj ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit e jo të vendos në merita pa i marrë për bazë faktet dhe argumentet e ngritura nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja pohon se kërkesa e parashtruesit është refuzuar në bazë të parashkrimit, konkretisht në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, me që rast i është referuar edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së I-rë të DHPGJS-së. AKP-ja kërkon që çështja të trajtohet edhe njëherë dhe të merren në konsiderate argumentet e Autoritetit të Likuidimit të dhëna në vendimin e ankimuar.

Më datë 05 korrik 2024, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruara si të pabazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm. Paditësi pohon se argumentet e saja i ka sqaruar mjaftueshëm në ankesë dhe në parashtresat e mëvonshme. Paditësi pohon se ka parashtruar kërkesë për rishikim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit lidhur me kompensimin e borxhit për ujën e shpenzuar të NSH "Kualiteti" dhe të aseteve të

saj në shumë prej 11,064.62 €. AKP-ja asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar, gjegjësisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do t'i mohohej e drejta në kompensim të faturave të ujit të shpenzuar. Nga këto arsye paditësi kërkon që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 22 mars 2011, e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit dhe kërkon kompensimin e faturave të pa paguara të ujit, që në bazë të faturave kjo periudhë është 01 shtator 2005 deri me 01 korrik 2008, në shumë prej 11,064.62 euro.

Autoriteti i Likuidimit këtë kërkesë e ka refuzuar si të pa vlefshme, me arsyetimin se paditësi lidhur me kërkesën e datës 24 maj 2013 për të ofruar informacione dhe dokumente shtesë, nuk është përgjigjur në afatin e caktuar prej 15 ditësh të përcaktuar nga Autoriteti i Likuidimit, por paditësi me datë 12 qershor 2013, ka kthyer përgjigjen jashtë afatit të parashikuar në letrën e dërguar, dhe për më tepër paditësi nuk dorëzoi kopjet e faturave për periudhën e kërkesës së tij, të cilat kërkoheshin si provë. Andaj në përputhje me nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit AKP-së, kërkesa e pa plotësuar me prova është refuzuar si e papranueshme.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit duke detyruar të paditurën që

paditësit në emër të kompensimit të faturave të papaguara të ujit ti paguan shumën prej 11,064.62 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurë të likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se AKP-ja, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohej e drejta në kompensimin e faturave të ujit të shpenzuar. AKP-ja faktet, në këtë rast EKSTRAKTIN dhe FATURAT e prezantuar nga ankuesi, nuk i ka kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga faktet se, si në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit po ashtu edhe përgjigjen ndaj kërkesës për rishikim, AKP-a nuk e mohoj faktin se EKSTRAKTI është prezantuar pranë Autoritetit të Likuidimit por vetëm konstaton se kjo dëshmi është parashtruar jashtë afatit të paraparë prej 15 ditësh, të cilin fakt nuk e mohon as ankuesi.

Kolegji i Apelit e mbështet në tërësi konstatimin e Shkalles së I-rë të DHPGJS-së, se paditësi me Ekstraktin nga Librat e Kontabilitetit që i për ketë periudhës nga 01.09.2005 e deri 01.07.2008, dhe me faturat e bashkangjitura mjaftueshëm i ka mbështetur pretendimet e tij për ekzistimin e borxhit që e ka NSH I.M.B "Kualiteti" në Gjilan ndaj tij në shumë prej 11,064.62 euro. Kjo shumë nuk është kontestuar nga AKP-ja, madje AKP-ja nuk ka arritur të dorëzoj ndonjë dëshmi se NSH-ja këtë borxh e ka shlyer.

Autoriteti i Likuidimit kërkesën e ka refuzuar si të pavlefshme, me arsyetimin se paditësi nuk i është përgjigjur kërkesës së tij për dokumentacion shtesë, në afatin prej 15 ditësh siç ishte kërkuar në atë letër. Megjithatë paditësi i është përgjigjur kësaj letre me datë 12 qershor 2013, duke dorëzuar Ekstraktin nga Librat e Kontabilitetit, që vërteton e ekzistimin e borxhit të NSH-së, dhe po ashtu edhe në shkallën e I-rë të DHPGJS-së ai ka dorëzuar edhe faturat e pa paguara të ujit, për të cilin dokumentacion dinte edhe Autoriteti i Likuidimit.

Është i saktë konstatimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së se refuzimi i kësaj kërkesë nga Autoriteti i Likuidimit, nuk është bërë për shkak të parashkrimit, dhe kjo shihet

edhe nga vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, por edhe nga mbrojtja në ankesë e AKP-së të dorëzuar me 01 mars 2024 në shkallën e I-rë.

Në procedurën ankimore në shkallën e dytë AKP-ja në ankesën e saj thirret edhe në parashkrim të kërkesës, që në fakt kjo nuk ishte arsye e refuzimit të kërkesës nga Autoriteti i Likuidimit, andaj ky pretendim nuk është marrë për bazë, dhe ai konsiderohet si pretendim jo i saktë i refuzimit të kërkesës, andaj është pretendim ankimor i pa bazuar. Kolegji i Apelit nga këto arsye nuk do të marrë qëndrim ligjor lidhur me çështjen e parashkrimit të kërkesës, pasi kjo nuk ishte arsye e refuzimit të kërkesës.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore:**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, me datë 10 qershor 2024, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 19 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues

---